



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Lëgjislatura e V
Komisioni për Buxhet dhe Financa
Mbledhja nr. 78/17
Prishtinë, më 31.01.2017, ora 11:00
Ndërtesa e Kuvendit të Kosovës, salla C-203

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR BUXHET DHE FINANCA

Ne mbledhje morën pjesë: Naser Osmani, Safete Hadërgjonaj, Shukri Buja, Labinotë Demi-Murtezi, Besa Gaxherri, Salih Morina dhe Fikrim Damka, Enver Hoti, Bali Muharremaj dhe Shqipe Pantina.

Mungoi: Jelena Bontic.

Pjesëmarrës të ftuar: Ismet Bexheti – Kryetar i Bordit të RTK-së, Mentor Shala – Drejtor i Përgjithshëm në RTK.

Pjesëmarrësit tjerë: Bujar Trei – RTV 21, Eugen Cakolli - Gazetar, Nebi Maxhuni – Gazetare nga RTK, Kushtrim Kadriu – Gazetar - K. info, Albulena Mavraj – Gazetare nga Epoka e Re, Rëjhane Zylyfijaj nga GIZ.

Nga stafi mbështetës i komisionit: Sabrije Iseini, Luljetë Krasniqi dhe Dashurije Canolli.

Mbledhjen e kryesoi: Naser Osmani, Kryetar i Komisionit.

Rëndi i ditës:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Shqyrtimi i Programit të Shpenzimeve të Radiotelevizionit të Kosovës për periudhën Janar-Mars 2017;**
- 3. Të ndryshme.**

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetari konstatoi se rendi i ditës miratohet pa ndryshime.

2. Shqyrtimi i Programit të Shpenzimeve të Radiotelevizionit të Kosovës për periudhën Janar-Mars 2017

Kryetari - bazuar në Ligjin për buxhetin e Republikës së Kosovës 2017, sipas nenit 11 paragrafi 5, të para secilit tre mujorë, RTK-ja do të dorëzojë në Kuvendin e Kosovës programin e shpenzimeve të planifikuara dhe raportin për shpenzimet e bëra. Mbi bazë të kësaj RTK-ja ka dorëzuar në Kuvend,

planin e shpenzimeve për tremujorin e parë (janar-mars 2017) ku kërkohet që të lejohet transferimi i mjeteve nga buxheti i Kosovës, në llogarinë zyrtarë të RTK-së.

Ismet Bexheti - sipas Ligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës, RTK ka përgatitur programin e shpenzimeve për tremujorin e parë 2017. Përveç 11 milion eurove që janë paraparë më buxhet të rregullt, në funksion janë 2.750.000 euro që janë kryesisht si të hyra nga marketingu. Sa i përket të hyrave tjera, ai deklaroi se për tremujorin e parë janë 50.000 euro ndërsa në tërësi janë në funksion 1.916.841 euro prej të cilave 1.565.250 euro janë për paga dhe 351.591 euro janë për mëditje, kontribute, sigurime dhe kontrata kolektive. Ndërsa 956.909 euro janë shpenzime të planifikuara për mallra dhe shërbime, 81.250 euro për komunalitet dhe për investime kapitale janë gjithsej 370.000 euro.

Besa Gaxherri - shprehu pakënaqësi ndaj përfaqësuesve të RTK-së që kanë qenë në gjendje të na ofroni dokumentet të cilat i kemi kërkuar nga ju, e cila ka pamundësuar bashkëpunimin dhe njëkohësisht të respektohet ligji. Sa i përket temës për të cilën po diskutohet, ju keni parashikuar t'i realizoni të hyra prej 525.000 euro nga marketingu, sikurse edhe të hyrat të tjera që kanë ardhur në tremujorin e fundit që janë të pa qarta dhe kërkon që të sqarohen? Njëkohësisht, në mesin e pesëmbëdhjetë zërave buxhetor, kërkojë që nga secili të këtë sqarim se çka planifikojnë, si për zërin buxhetor pajisje dhe rrjeti i sigurisë, pajisje e rezervuar për aplikimin e teknologjive të reja që janë 8.700 euro dhe për inventarin që janë 12.500 euro? Për mallra dhe shërbime më 15 zëra buxhetorë si dhe shfrytëzimi i formave të lajmeve për nevoja programore nga televizionet dhe agjensionet e pavarura vendore që kanë shumën e njëjtë prej 6.205 euro. Përderisa tek të agjencitë ndërkombëtare lajmi duhet të paguhet, tek agjencitë vendore çfarë lajmi duhet të paguhet për ta marrur?

Vërejtje të tjera shpreh edhe të programi për produksionet e pavarura dhe në numrin e punëtorëve për të cilët nuk e di se sa paguhet, a vlerësohen se a e bëjnë punën e tyre si duhet? Në mesin e temës së njëjtë përshtypje jo të mirë është kur punëtori i cili paguhet në RTK, bënë edhe produksion dhe ia shet RTK-së dhe kjo është e papranueshme.

Për shërbimet për programe, krahasuar më numrin e madh të punëtorëve, është papranueshme mos angazhimi i televizionit për aftësim të atyre punëtorëve dhe bërjen e emisioneve brenda. Përveç shërbimeve programore të cilat janë të caktuara, paqartësi ka edhe tek shërbimet programore të tjera për të cilat është e caktuar shuma prej 23.250 euro. Në rendin enpaqartësisë hyn edhe shuma prej 7.500 euro të caktuara për programin e vitit të ri që është e pakuptimtë edhe pas kalimit të vitit të ri.

Një pyetje direkte shkon në lidhje më shërbimet kontraktuese dhe korrespondente, pse shumë qytete të tjera janë të mbuluara nga RTK, përveç qytetit të Pëjes dhe Mitrovicës? Në shpenzimet e radhës hyjnë edhe shpenzimet e tjera operationale që janë 14.113 euro dhe për shpenzime të udhëtimeve zyrtare jashtë vendit që janë 50.000 euro e që këto të dyja, për tre mujorin e parë janë absurde. Duke mos dashur të fajsojë apo të arsyetojë kryetarin e Bordit sepse e kupton se si shkon procedura në televizion, përsëri ju duhet t'i keni gjithmonë të gjitha të dhënat e RTK-së, pasi që ka ndodhur shumë shpesh që nuk i keni të dhënat të cilat u janë kërkuar. Vërejtjen e fundit është për sjelljen e zyrtarëve të RTK-së të cilët nuk sillen sipas ligjit dhe dalin publikisht duke bërë fyerje për zyrtarë të caktuar politik apo institucional, gjë e cila iu ndalohet më ligj.

Shqipe Pantina - falënderojë anëtarët e grupit punues që kanë qenë të ngarkuar për të analizuar raportin dhe shpenzimet e RTK-së dhe kanë prezantuar një raport i cili nuk është i detajuar, si mungesë e informacioneve të kërkuara. Deputetja Gazheri theksoi se e kanë kërkuar na nga RTK-ja listën e pagave, ndërsa u është ofruar lista e punëtorëve. Tek kjo listë, kam pyetje konkrete sa i përket punëtorëve ku një anëtarë i bordit quhet "Naim Gashi" dhe një punëtor tjetër i sigurimit është më po të njëjtin emër dhe mbiemër. Këtu fillon paqartësia se a bëhet fjalë për personin e njëjtë apo për dy persona të ndryshëm. I njëjti rast ndodh është më punëtorin e RTK-së Milaim Zeka i cili është redaktor i emisioneve dhe njëkohësisht drejton emisionin "Pa Rrotlla", për të cilin emision, RTK-ja paguan 40.000 euro në vit. Pyetja ime konkrete është se a paraqet kjo konflikt interesi apo në çfarë procedura kalon ky fakt?

Pyetja tjetër ka të bëjë më të paktën dy punëtore si me "Jeta Citakun" redaktorë e muzikës dhe "Rozafë Metaj" gazetarë, pse janë në listën e pagave, pasi që këto të dyja nuk jetojnë më në Kosovë dhe vazhdojnë të marrin paga nga RTK-ja? Unë kam pritur që të marrë raportin e buxhetit për tremujorin e vitit të kaluar për të pasur mundësi që t'i krahasojnë shpenzimet por kjo gjë nuk kishte ndodhur.

Nuk është e pranueshme që përderisa janë të ndara 7.587.000 euro për paga, kontribute, sigurime etj. në të njëjtën kohë janë para të tjera për blerjen emisioneve të gatshme duke përfshirë këtu edhe agjensitë e lajmeve, gjë që nuk duhet të ndodhë pasi që emisionet informative, RTK-ja duhet t'i prodhojë vet dhe që krahas këtij fakti, numri i punëtorëve duket edhe më i pakuptimtë. Kërkojë sqarim për shumën 1.500.000 euro për investime kapitale dhe 100.000 euro për digjitalizimin e arkivës filmike që kërkon pse janë shuma kaq të mëdha. Para të tjera janë ndarë për kompjuterë, inventar etj. shumë e të cilës është 50.000 euro dhe kërkon që të kuptojë se pse duhet patjetër të ndahet veçmas për TV 2 sepse ju jeni një shtëpi dhe shpenzimet e pajisjet duhet të jenë të përbashkëta? Ajo po ashtu theksoi se për zgjedhjet komunale, brenda vitit shpenzohen 100.000, ndërsa shpenzimet për telefon arrin shumën prej 90.000 eurove e në anën tjetër, televizioni paguan korrespondent pothuajse në të gjitha qendrat kryesore të qytetit që brenda kësaj përmendet është shuma e harxhuar për karburant që arrin në 85.000 euro. Në shpenzime të larta hyn edhe menaxhmenti, më saktësisht udhëtimet jashtë vendit më 200.000 euro për të cilat nuk dihet se a janë vizita studimore, trajnim apo shëtitje, kurse të njëjtat vërejtje janë edhe për shpenzimet e bordit të cilat janë jashtëzakonisht të larta. Brenda këtyre vërejtjeve, shfrytëzon rastin të përmend edhe për deklarata jo të sakta prej RTK-së sa i përket rrogave të deputeteve ku është thënë se ata po i rrisin rrogat e tyre e që ende nuk ekziston një ligj i tillë.

Shukri Buja – sa i përket raportit të grupit punues të ngarkuar nga i cili është dalur kërkesa për kontratat e punëtorëve, veprim të cilin e konsiderojë antiligjor pasi që ekziston ligji për mbrojtjen e të dhënave personale dhe në bazë të këtij ligji, çdo punëtor mundet të ngris padi. Përshtypjet e tij ishin tek raporti financiar për tremujorin ku dymbëdhjetë herë është shifra 12.500 euro e që iu është dukur gjithëpërfshirëse. Sa herë janë përmendur shumat e njëjta dhe gjatë bisedës thekson se nuk e kupton sesi është bërë raporti dhe nuk ka mundësi që komunalit të kenë të njëjtën shifër sikurse tatimi, ueb faqet, pastrimi, ujësjellësi e telefonia fikse. Rreth planifikimit buxhetor të vitit 2017, shpreh kënaqësinë e tij për respektimin e kontratave kolektive mirëpo krahason se nëse kjo gjë do të ndodhte më kryetarët e komunave, RTK-ja do të bënte shumë akuza e tema të gjata rreth asaj çështjeje sikurse edhe mediat tjera. Për këtë model, sa i përket respektimit të kontratave kolektive, i fton edhe kryetarët e komunave që të zbatojnë të njëjtën gjë.

Enver Hoti - pa dashur që t'i përsërisë pyetjet dhe vërejtjet e njëjta me koleget e tij, Hoti thekson se ka pasur takime dhe kontakte të vazhdueshme me bordin drejtues të RTK-së. Pakënaqësi të madhe shpreh rreth gjendjes aktuale ku ka mungesë të besimit në mes të drejtuesve të bordit ku e shpjegon si funksionim të shkapërderdhur dhe aspak në krye të detyrës. Ai shpjegon po ashtu raste ku antari i bordit i është drejtuar më kërkesa konkrete në lidhje me funksionimin e RTK-së drejtorit ekzekutiv dhe asnjëherë nuk ka marrur përgjigje duke e konsideruar si çështja shqetësuese dhe po i humbë edhe kuptimin e ekzistencës së bordit drejtues.

Sa i përket kërkesave të deputeteve, ai thekson se ato kërkesa kanë hasur në përgjigje të pa pranueshme dhe njëkohësisht, shfrytëzon rastin të bëjë thirrje për funksionalizimin e komisionit hetimor të cilin e ka krijuar Kuvendi i Kosovës. Deputeti përmend numrin e rregullt të punëtorëve të RTK-së që është 729, mbi 215 punëtorë me kontratë mbi shërbime dukë thënë se mund të këtë edhe lëvizje të reja mbi të cilat, as drejtori ekzekutiv dhe as kryetari i bordit nuk e dinë se sa punëtorë kanë në televizion. Po ashtu planifikimit financiar për këtë trimujorë për zgjedhjet komunale më shifra gjithëpërfshirëse është mashtrim dhe kjo është tentativë për mashtrim apo arsyetim të disa rrjeteve që kanë për detyrë të paguajnë disa shërbime, aneks kontrata apo benefite të ndryshme për të cilat nuk ë di se pse paguhen. Vërejtja ka edhe tek rregullorja e punës së bordit të RTK-së për mungesë të precizimit. Si rrjedhojë e këtyre çështjeve të pa qarta, nuk do ta votojë kërkesën që ka bërë RTK-ja.

Safete Hadërgjonaj – kërkoj që përfaqësuesit e RTK-së të japin sqarimet e duhura ndaj vërejtjeve që u thanë nga deputetët e pranishëm sepse disa shpenzime nuk janë të detajuara edhe pse është evidente se programi i shpenzimeve të kësaj periudhe është më i detalizuar se sa në periudhat e kaluar. Megjithatë në programin e tremujorit të ardhshëm, kërkohet që të ketë detaje të hollësishme. Duke u bazuar në disa tema të ditës të pa nevojshëm nga televizionet dhe mediat private për grupacion politike, ku këto media i bëjnë për interesa personale, fton televizionin publik pasi që edhe financohet nga buxheti i Kosovës, që këto lajme t'i filtrojë që të jenë më të besueshme.

Labinothë Demi Murtezi - pyeti përfaqësuesit e RTK-së sa i përket inventarit ku thotë së, derisa televizionit i duhet më shumë zhvillim të teknologjisë, pse i duhen 12.500 euro inventar!

Në listën e vërejtjeve janë edhe investimet për emision ku kritika negative ka sa i përket emisioneve të caktuara për fëmijë, emisione edukative për të rritur, emisione shkencore ë të cilat janë pa emër. Pyetje ka të bëjë për shpenzime komunale ku shpenzim i pa kuptim është telefonia dhe interneti. Po ashtu edhe për ujësjellsin bënë pyetje se pse është shifra e shpenzimit rreth 5625 euro kur të planifikuara janë 5000 euro?

Shpenzime prej 5750 euro për komunalitë e tjera, janë po ashtu shumë të pa qarta. Po ashtu pajtohem me kërkesën për sqarimin e shpenzimeve që i ngriti deputetja Gaxherri si dhe sqarim më të zgjeruar kërkon për bordin këshillues për publikun për të cilin nuk e kupton së kush bënë pjesë aty sëe qka nënkupton ky bord? Një krahasim bënë edhe për cilësinë dhe mungesën e lajmit ku thot së RTK-ja nuk ka dallim të madh me televizionet e tjera si KTV apo më Klan Kosova. Në fund nëse kemi arritur të marrim një projektim të buxhetit për tremujorë kjo nuk pasqyron suksesin pasi që duhet të rishikohet Ligji për RTK-në dhe të specifikohen gjërat si në rregullore, ashtu edhe në ligj.

Sali Morina - për çështjen e zgjedhjeve komunale shuma e paraparë prej 25.000 euro do të ishte më mirë që të shkonte në investime kapitale. Për zërin buxhetor në lidhje më programin e vitit të ri që janë rreth 7500 euro propozon që të bartët aty ku ka më shumë nevojë. Deputeti Morina i drejton kryetarit të bordit që ka të bëjë thirrjen publike të zyrtarëve të lartë ndaj redaktorit të televizionit dhe është i interesuar të dijë së çfarë masa janë ndërmarrur ndaj tij?

Ismet Bexheti - thekson se raporti i cili u është dhënë, është bërë në bazë të kërkesës e cila nuk ka kërkuar detaje të hollësishme siç përmendët tani. Sa i përket listës së pagave të punëtorëve të RTK-së, në kemi qenë në mëdyshje për shkak të ligjit të mbrojtjes së të dhënave personale. Ndërkaq për produksionet e pavarura që u përmendën rreth 610.000 euro, ne e kemi obligim që t'i paguajmë pasi që kjo luan rol të madh në prezantimin e ideve nga jashtë dhe taksapaguesve në aspektin e veprimtarisë mediale. Në pyetjen e deputetes Murtezi sa i përket bordit këshillues të publikut, është një obligim ku del nga ligji aktual për RTK-në dhe kjo patjetër duhej të formohej prej kohësh. Në lidhje me shkeljen e legjislacionit, ne si bord kemi marrur hapa të duhur dhe kemi bërë rekomandim drejtuar drejtorit të përgjithshëm që duhet të merrrën masat konform rregullores.

Mentor Shala – sqaroi se sa i përket qështjes së ngritur nga znj. Pantina për emrin e Naim Gashit nuk është i njëjti person, pra njëri punon në sigurim dhe tjetri është anëtar i bordit kurse, sa i përket dy emrave të tjerë Jerta Citaku dhe Rozafë Metaj, ato nuk paguhen sepse ato nuk janë pjesë e televizionit dhe kjo ndalohet me ligj. Në temën e diskutimit të programi, Shala thekson së si rezultat i trasnmetimit prej 96 orësh program televiziv dhe 48 orë program të radios ku kemi pastaj edhe ueb faqet dhe mediat online, kjo nënkupton së RTK-ja është rritur dhe ka nevoja shtesë për buxhet. Në pyetjet për pajisjet e rrjetës dhe sigurisë kjo ka të bëjë me qështjen e teknologjisë. Kjo qështje ndërlidhet pasi që RTK-ja ka kaluar nga metodat e vjetra, në sistem digjital dhe cdo vit duhet të bëhet përditësimi i teknologjive të reja për siguri të rrjetit dhe këto pajisje janë të kushtueshme. Në qështjen në vazhdim, Shala shprehet i gatshëm të sqarojë paqartësitë rreth pajisjet rezervë për aplikimin e teknologjive të reja ku përmend që

RTK-ja ka filluar të zhvillojë procesin e gazetarisë më pajisje të reja. Për inventarin Shala thekson se investimet që bëhen në RTK, më saktësisht kur bëhet fjalë për TV 1 dhe TV 2, thotë se ne nuk jemi në një objekt dhe atyre ju duhen investimet shumë, madje janë të limituar sa i përket buxhetit.

Shala i jep përgjigje edhe deputetes Murtezi në lidhje me emisionet pa emra duke thënë se nuk është e mundshme ta dimë gjithmonë qdo emër të emisioneve pasi që jemi ende transmetues dhe medium. Ajo që dihet është se do t'këtë emision edukativ për fëmijë, por jo edhe llojin. Shala kalon në çështjen e karburanteve si një ndër të pa qartat e antarëve të pranishëm, dhe sqaron se këto shpenzime, nëse krahasohen me vitet e tjera, rreth 60% janë shpenzimet më të vogla. Karburantet sidomos në terren të gazetarëve janë më së të nevojshme. Rreth diskutimit për arkivën filmike, ai thekson se arkiva filmike që daton prej vitit 1960 deri afërsisht në vitin 1998, është në kushte të mjerueshme. Sa i përket zgjedhjeve komunale në të cilat kishë mëdyshje nga deputetet dhe thotë se nëse hiqen 25.000 euro nga zgjedhjet komunale dhe shfrytëzohen diku tjetër, në zgjedhjet e ardhshme do të mbesin në minus 25.000 euro.

Enver Hoti - njëri nga anëtarët e bordit të RTK-së ka shprehur pakënaqësi ndaj jush si bord dhe ka deklaruar se është i akuzuar se është i dërguar në bord për qëllime politike dhe është e vërtetë se përgjithësi nuk ekziston një bashkëpunim i mirë dhe për interesa të RTK-së. Në veçanti i drejtohet kryetarit të bordit për të cilin mendon se nuk mund të luajë rolin e kryetarit të bordit pasi që ka ndikime politike dhe anëtari i bordit që është i akuzuar për qëllime politike ka bërë kërkesa më muaj të tërë nga ju lidhje më gjendjen konkrete dhe ju nuk i keni dhënë asnjë përgjigje.

Shukri Buja - a keni auditor të brendshëm pasi që sipas ligjit për financa publike nëse një organizatë buxhetore ka mbi 10.000.000 euro, duhet t'i këtë së paku tre auditorë të brendshëm?

Ismet Bexheti - bordi drejtues ka insistuar që të krijohet njësia e auditimit të brendshëm ku përbëhet nga tre auditorë. Duke dashur të jetë sa më bindës, ai thotë se ky mekanizëm është një ndër mekanizmat që ka vërë në funksion sistemin e kontrollit të brendshëm deri më tash.

Besa Gaxherri - insiston të dijë së për çka janë të hyrat prej 50.000 eurove. Pas kësaj, ajo thotë se pas gjithë këtyre vërejtjeve që u dhanë nga pothuajse secili deputet, kjo kërkesë është vështirë të votohet megjithatë, duhet të bëhet një zgjidhje. Kërkohet që duhet të bëhet respektimi i ligjit dhe kryerja e obligimeve nga RTK-ja por edhe të bëhen ndryshime në buxhet.

Kryetari - theksoi së në lidhje më çështjen që ngriti deputeti Hoti sa i përket funksionalizimit të komisionit hetimor, nuk është çështja e komisionit por është çështja që i përket kryesisë së Kuvendit dhe Parlamentit të Kosovës. Po ashtu, ai tha së në lidhje më deklarime politike të disa zyrtarëve të lartë të RTK-së, drejtori i bordit duhet të ndërmarrë masa ligjore që të mos ketë fyerje ndaj institucioneve tjera të Kosovës nga ky institucion që ka tjetër përgjegjësi ligjore. Kryetari deklaroi së për deputetët nuk ka asnjë dokument sekret e as lista e pagave siç është cekur më herët.

Ai fton për bashkëpunim të ngushtë drejtorin e RTK-së dhe kryetarin e bordit që bashkërisht të bëjnë planin e detajuar të shpenzimeve për vitin 2017. Kryetari kërkon nga komisioni që të angazhohen në këtë drejtim dhe të gjitha konstatimet që komisioni i dërgon RTK-së, televizioni duhet t'i merr për bazë.

Pas përfundimit të diskutimeve dhe në bazë të propozimit, kryetari konstatoi së Komisioni më shtatë vota Për, asnjë Abstenim dhe tre Kundër, nxori këtë

Rekomandim

- I. I rekomandohet Ministrisë së Financave, respektivisht drejtorit të përgjithshëm të Thesarit, të bëjë transferin e mjeteve buxhetore nga Llogaria e Fondit të Konsoliduar të Republikës së Kosovës, nga buxheti i Radiotelevizionit të Kosovës – kategoria ekonomike, subvencione

- dhe transfere, në llogarinë e RTK-së nr. 1110101219060187, për periudhën 1 janar - 31 mars 2017, në shumën prej 2,750,000 (dy milionë e shtatëqind e pesëdhjetë mijë) euro.
- II. Grupi punues të vazhdoje punën edhe në vitin 2017, dhe Kryetari i Bordit dhe Drejtori i RTK-së të bashkëpunojnë ngushtë me grupin punues dhe bashkërisht të përgatitin planin e shpenzimeve të RTK-së për vitin 2017.
 - III. Grupi punues të bëjë një raport për RTK-ën, dhe komisioni në një ditë të veçantë të caktojë një takim që t'i diskutojë çështjen e shpenzimeve dhe planifikimit të RTK-së, dhe të gjitha ato konstatime që dalin nga Komisioni, RTK-ja duhet t'i marrë për bazë.

3. Të ndryshme

Në bazë të propozimit, kryetari konstatoi se Komisioni caktojë grupin punues për organizimin e Punëtorisë për specifikimin e aktiviteteve të komisionit në vitin 2017. Grupi punues përbëhet nga Salih Morina (kryesues), Bali Muharrëmaj dhe Shukri Buja.

Mblëdhja përfundoi në ora 13:30

Përgatitur nga:

Njësia për mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit

Naser Osmani